

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - sherbim**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

Objekti: “Sherbim mirembajtje Full - Risk te pajisjeve mjekesore CT, Skaner, MRI, Rezonance Magnetike për nevoja të Spitalit Rajonal Vlorë” ndare ne 2 lote, marreveshje kuader me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara, me afat 1 vjecar (12 muaji)

Fondi Limit : 22,586,400 (njetzet e dy milion e peseqind e tetedhjetë e gjashtë mijë e katerqind) Lek pa tvsh- e konvertuar në Euro, sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, datë 16.10.2024 *eshte* 228’630.4 (dyqind e njetzet e tete mijë e gjashtëqind e tridhjetë pike kater) euro pa TVSH.

Loti 1 - Mirëmbajtje Full Risk “Rezonancë magnetike/Philips model Intera 1.5 T” per nevoja te Spitalit Rajonal Vlorë.

Loti 2 - Mirëmbajtje Full Risk “CT Skaneri/Philips model MX 16” per nevoja te Spitalit Rajonal Vlorë

REF-25140-10-17-2024

Loti 1 – REF- 25172-10-17-2024

Loti 2 – REF-25180-10-17-2024

Kodi sipas Fjalorit te Perbashket te Prokurimit: 50421000-2

Loti 1 – Objekti: Mirëmbajtje Full Risk “Rezonancë magnetike/Philips model Intera 1.5 T” per nevoja te Spitalit Rajonal Vlore

	Philips		
Nr.	Pajisja	Prodhuesi/	
		Modeli	Sasia/cope
1	Rezonancë Magnetike	Philips model Intera 1.5T	1

Loti 2 - Mirëmbajtje Full Risk “CT Skaneri/Philips model MX 16” per nevoja te Spitalit Rajonal Vlorë

	Philips		
Nr.	Pajisja	Prodhuesi/	
		Modeli	Sasia/cope
2	CT Skaner	Philips model MX 16	1

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Spitali Rajonal Vlore** ka hartuar procesverbalin për

argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT – (te njejtë për te 2 lotet)

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbështetje në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

2. 2. Kandidati/ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: (te njejtë për te 2 lotet)

1. Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 (nje) inxhinier për mirëmbajtjen e aparaturave objekt të këtij prokurimi me profil inxhinier biomjekësor/ elektronik/ elektrik/ mekatronik/ mekanik ose degë të tjera të ngjashme me to.

Për këtë OE duhet të disponojë dokumentat e mëposhtme provuese për secilin nga stafi më sipër:

- CV-në e specialistit/ve;
- Çertifikatat/ dëshmitë e trajnimit për pajisjet objekt prokurimi, lëshuar nga kompania prodhuese ose ekuivalentet e këtyre çertifikimeve lëshuar nga autoritete të autorizuar/certifikuara për dhënien e tyre;
- Kontratë pune/ shërbimi e vlefshme.

- Listëpagesa ku të figurojnë emrat e inxhinierëve të deklaruar për periudhën **gusht 2024**.

* Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST.

Shenim:

Referuar pikes 1, të nenit 26, të vkm nr .285, date 19.05.2024, i ndryshuar, ku parashikohet “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla si dhe përcaktimet e pikes 6, të ketij neni ku parashikohet: Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të 21 Shtuar me VKM 498/2024 22 Shtuar me VKM 498/2024 29 ketij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: Bazuar në pikën 4, të nenit 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikave 4/b dhe 4/c të nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar: – te njejta per te 2 lotet

1. Operatori ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiar 2021, 2022,2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit/vlera e pritshme e kontratave të lotit apo shumës së loteve për të cilat oferton sipas tabelës së mëposhtme. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr 162/2020, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci të tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.; në pikën 1 dhe pikën 2/a të nenit 43 të VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/a: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që*

u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve te kërkuaara me poshtë, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për te permbushur kontratën siç është parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Legjislatori në piken 1 dhe piken 2/a te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur, ku përcaktohet; Pika 2/a: **2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar**

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuaara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 ‘Mbi Rregullat e Prokurimit Publik’ i ndryshuar ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 ‘Për Tatimin Mbi të Ardhurat’ i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave.

2.3 Kapaciteti teknik: te njejta per te 2 lotet

2.3.1 Nje deklarate që merr përsipër zevendesimin e pjesëve te këmbimit dhe konsumit, që ato do jenë të reja dhe origjinale dhe ne përputhje me ato te përdorura fillimisht (te garantuara nepermjet certifikimit CE ose FDA) dhe që përfshihen në vlerën e kontratës dhe se garancia e pjesëve të këmbimit do të jetë për një periudhë jo më pak se një vit nga momenti i lëvrimit.

Argumentimi: Bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 2 të nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku ndër të tjera përcaktohet se keto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për te provuar kapacitetet teknike dhe profesionale.

Në mbështetje të Nenit 17 të Ligjit nr.89/2014 “Për pajisjet mjeksore” si dhe të nenit 7 të ligjit 21/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 89/2014”, krahas kërkesës së miratimit/certifikimit CE, AK lejon edhe mundësinë e paraqitjes së certifikatës FDA, si një dokument, i cili konfirmon konformitetin e pajisjeve/artikujve mjekësore objekt prokurimi, me qëllim hartimin e kriterit në konformitet me dispozitat në fuqi, si dhe moskufizimin e OE, të cilët tregtojnë dhe paraqesin pajisje dhe artikuj mjekësore vetëm me certifikimin FDA dhe jo me certifikimin CE.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizimin nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për tregtim të pajisjeve mjekësore.

Argumentimi: Ky kriter vihet në përputhje me piken 2 te nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” lidhur me kualifikimin profesional dhe aftësinë teknike :Për sa i përket

përshatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

2.3.3 Ofertuesi duhet të jetë i certifikuar ISO 9001:2015/ose/ ekuivalent, objekti i së cilës t'i përkasë fushës së aktivitetit të OE. Për këtë ai duhet të paraqesë certifikatën përkatëse, të vlefshme. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Ky kriter vihet në përputhje me pikën 1 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” lidhur me kualifikimin profesional dhe aftësinë teknike dhe me pikën 3 të nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Ky kriter është i lidhur ngushtë me objektin e kësaj kontrate si dhe me aftësinë zbatuese të kontratës, me garantimin e kapaciteteve profesionale nga OE pjesëmarrës si dhe rekomandimit të APP nr. 7998 datë 24.12.2021 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime”.

2.3.4 Një deklaratë që pranon oraret e kryerjes së shërbimeve dhe shpejtësinë e ndërhyrjeve

Argumentimi: Bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 2 të nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku ndër të tjera përcaktohet se keto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale.

2.3.5 Planin e veprimeve të mirëmbajtjes parandaluese që ofertuesi do të ndërmarrë, për secilin grup pajisjesh, ku të përcaktohen periodiciteti, procedurat operative dhe protokollat që do të përdorë përfshirë kalibrimet dhe testimet periodike të sigurisë elektrike dhe mekanike të pajisjeve në përputhje me standartet përkatëse evropiane. Ky plan veprimi duhet të jete mujor dhe në përputhje me katalogun e prodhuesit të pajisjes për të cilin operatori ekonomik oferton.

Ne vijim të këtij kriteri duke marr parasysh përvojën e mëparshme dhe kompleksitetin e kësaj Procedure në planin e mirëmbajtjes 12 mujor do të pranohen edhe risi shërbimesh nga ana e Operatorit, mjafton që të jenë në përputhje me katalogun e prodhuesit të pajisjes.

Argumentimi: Bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 2 të nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku ndër të tjera përcaktohet se keto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shtojca 6.

1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TE SHERBIMIT– per te 2 lotet

Mirëmbajtja full risk e pajisjeve mjekësore që janë në përdorim në SRV sipas përshkrimit të më poshtëm të shërbimit.

	Philips	
Nr.	Pajisja	Prodhuesi/ Modeli
1	RezonancëMagnetike MRI	Philips model Intera 1.5 T
2	CT Skaner	Philips model MX 16

Shërbimi i mirëmbajtjes për pajisjet do të jetë Full risk ku ofruesi i shërbimit merr përsipër kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes parandaluese si dhe korrigjuese për të gjithë difektet që mund të ndodhin përfshirë edhe zëvendësimin e pjesëve të këmbimit.

Mirëmbajtja full risk duhet të përfshijë shërbimet e mirëmbajtjes parandaluese, riparuese dhe zëvendësimin e pjesëve të këmbimit. Kjo kontratë duhet të garantojë performancë të punës së pajisjeve, vazhdimësinë e punës së tyre duke ofruar shërbim pa ndërprerje për pacientët duke mundësuar shfrytëzimin eficient të këtyre pajisjeve.

Pajisjet mjekësore objekt i kësaj procedure, janë pajisje shumë komplekse. Përdorimi i këtyre pajisjeve kërkon staf të kualifikuar e çertifikuar nga prodhuesi. Riparimi i këtyre pajisjeve duhet të kryhet vetëm nga specialistë të kualifikuar dhe të trajnuar posaçërisht për secilën nga pajisjet, pranë prodhuesve respektive si dhe të autorizuar prej tyre, për shkak jo vetëm të kompleksitetit por edhe të rrezikshmërisë së lartë që paraqesin për shëndetin e njerëzve.

Duhen marrë gjithmonë masat për zëvendësimin në kohë të saj si dhe pjesëve të këmbimit me qëllim mosndërprerjen e funksionimit të shërbimit.

Pajisje të prodhuesit Philips

Shërbimet që duhet të ofrohen: *Mirëmbajtja full risk e pajisjeve mjekësore (lista më poshtë) që janë në përdorim në Spitalin Rajonal Vlore sipas përshkrimit të më poshtëm të shërbimit.*

Philips		
Nr.	Pajisja	Prodhuesi/
		Modeli
1	RezonancëMagnetike MRI	Philips model Intera 1.5 T
2	CT Skaner	Philips model MX 16

Specifikimet teknike

Mirëmbajtja parandaluese: ky shërbim duhet të kryhet periodikisht sipas rekomandimeve të prodhuesit, me qëllim parandalimin e defekteve që lidhen me përdorimin e pajisjeve dhe pjesëve përbërëse, për të ruajtur sistemin e pajisjet në gjendjen e duhur të funksionimit, për të siguruar cilësinë dhe besueshmërinë e rezultateve të çdo pajisjeje, për të evidentuar gjendje të tilla si vjetrimi apo përkeqësimi i performancës së pajisjeve.

Mirëmbajtja korrigjuese: Ky shërbim do të përfshijë përcaktimin e pranisë së një defekti ose mosfunksionim, identifikimin e shkaqeve, eliminimin e shkaqeve dhe defekteve dhe rivendosjen e karakteristikave origjinale, verifikimin e integritetit të pajisjes, të funksionimit dhe në kontrollin e sigurisë sipas rekomandimeve të prodhuesit. Ky shërbim do të përfshijë edhe lëvizjen, spostimin, çmontimin dhe rimontimin e pjesëve të pajisjes gjatë mirëmbajtjes dhe kalibrimin.

Ndërhyrjet duhet të synojnë nxjerrjen në pah të të gjitha situatave të rrezikut të mundshëm dhe të identifikojnë veprimet korrigjuese me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë së spitalit, duke marrë parasysh kushtet specifike mjedisore dhe operative në të cilat ato operojnë me pajisjet dhe karakteristikat individuale të projektimit dhe ndërtimit të tyre, duke iu referuar periudhës së vendosjes së tyre në treg. Në lidhje me çdo mospërputhje të zbuluar gjatë zbatimit të kontrolleve dhe sipas nivelit të rrezikut të identifikuar

Ndërhyrjet e nevojshme do të sigurojnë eliminimin e të gjitha mos konformiteteve të konstatuara në pajisje dhe pjesën e furnizimit të burimit të ushqimit. Këto ndërhyrje janë në ngarkim të të Kontraktuarit dhe përfshihen në vlerën e kontratës.

Përveç afateve të përcaktuara në kalendarin e verifikimit periodik, shërbimi i verifikimit të sigurisë së përmendura në këtë pikë duhet të parashikohet edhe pas mirëmbajtjes korrigjuese, kur është e zbatueshme.

Kontraktuesi ka të drejtë të kërkojë verifikime përveç atyre të planifikuara, në raste të veçanta, në kushte apo sipas nevojave të veçanta.

Ofertuesi duhet të lëshojë një deklaratë që merr përsipër sigurimin teknik të stafit të tij gjatë kohës së punës në spital dhe se spitali nuk mban asnjë përgjegjësi për aksidentet e ndodhura punonjësve të kompanisë në ambientet e tij.

Pjesët përbërëse të sistemit, të këmbimit, përdorimit dhe konsumit.

Të gjitha pjesët e këmbimit dhe konsumit të mëposhtme janë në ngarkim të të Kontraktuarit dhe përfshihen në vlerën e kontratës:

- Tubi i rezeve X (blerja dhe instalimi i saj në rast dëmtimi) për pajisjet përkatëse
- Gjeneratori
- Të gjitha pjesët e tjera të këmbimit, të nevojshme për funksionimin sipas standardeve.
- Blerja dhe furnizimi me helium (për rezonancën magnetike)
- Pajisja UPS i pajisjeve
- Të gjitha pjesët e tjera të këmbimi që mund të lindë nevoja të zëvendësohen kur difektohen, me qëllim mirëfunksionimin e pajisjes.
- Çilleri

- Kondicioner- Te gjitha shërbimet për kondicionerët që janë brenda dhomave teknike (si dhe dhomes ku kryhen ekzaminimet përkatëse për Paisjet e Rezonancës dhe të Skanerit) do të mbulohen nga i Kontraktuari i cili duhet të parashikojë blerjen dhe zëvendësimin e kondicionerit ose pjesëve të tij (nese ndodhin defekte/prishje) gjatë ekzekutimit të kontra

I Kontraktuari duhet të parashikojë blerjen dhe zëvendësimin e të gjitha pjesëve dhe materialeve të këmbimit gjatë kryerjes së shërbimeve me shpenzimet e tij. Materialet dhe pjesët e këmbimit duhet të jenë të reja, origjinale dhe gjithmonë në përputhje me ato të përdorura fillimisht në pajisje, në përputhje me legjislacionin për pajisjet mjekësore duke siguruar konformitetet me udhëzimet e dhëna nga prodhuesi në dokumentacionin teknik furnizuar me pajisjen. Garancia e pjesëve të këmbimit do të jetë për një periudhë jo më pak se një vit nga momenti i lëvritimit.

Ky procesverbal u ngarkua në SPE nga Njësia e Prokurimit sipas modelit të APP.Specifikimet teknike janë vendosur në bazë të procesverbalit të dorëzuar nga Grupi i Punës i ngritur me urdher të brendshëm nr.prot 3630 datë 13.09.2024

Njësia e Prokurimit :